



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

DRAFT

PROJEKT VENDIM

**“PËR RREGULLAT MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
TË MJEDISIT DHE AGJENCIVE RAJONALE TË MJEDISIT”**

Draft 1

Version 6

26 Shtator 2013



100 Vjet Pavarësi

DRAFT VKM

26 shtator 2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

NR. _____, DATË _____

**“PËR RREGULLAT MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
TË MJEDISIT DHE AGJENCIVE RAJONALE TË MJEDISIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 59/4 të ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. OBJEKTI

1. Ky vendim përcakton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve, si dhe për marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.

II. PËRKUFIZIME

2. Termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

- a) “Ministër” është Ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
- b) “Ministria” është Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
- c) “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit në përputhje me ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- d) “ARM” janë agjencitë rajonale të mjedisit në përputhje me ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- e) “AMP” është Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 23.8.2006 “Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve”;
- f) “TMD” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.10 448 datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit";

- g) "PMM" nënkupton Praktikën më të Mirë Mjedisore;
- h) "Ligji "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" është ligji nr.10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
- i) "Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit" është ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- j) "Ligji "Për lejet e mjedisit" është ligji nr.10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit";
- k) "Ligji "Për statusin e nëpunësit civil" është ligji nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil";
- l) "Kodi i Punës" është ligji nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë";
- m) "Kodi Civil" është ligji nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- n) "Njësitë e Qeverisjes Vendore" kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e njësiteve të qeverisjes vendore";
- o) "Operator" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

III. KRIJIMI I AKM-së

3. AKM është institucion qendror publik në varësi të Ministrit.
4. AKM ushtron funksionet e ngarkuara nga ligji "Për mbrojtjen e mjedisit", ligji "Për lejet e mjedisit", ligji "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ky vendim dhe çdo legjislacion tjetër i posaçëm.
5. AKM ka pavarësi në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e funksioneve të saj.
6. AKM ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës së saj qendrore dhe ARM-ve.
7. Nëpunës civil të AKM-së janë punonjësit që ushtrojnë detyra drejtuese, organizuese, mbikqyrëse ose ekzekutuese. Nëpunësit civil rekrutohen në përputhje me ligjin "Për statusin e nëpunësit civil".
8. Punonjësit e AKM-së që kryejnë detyra të karakterit mbështetës i nënshtrohen Kodit të Punës.

IV. DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM-së

9. Titullari i AKM-së është Drejtori i Përgjithshëm.
10. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit.
11. Drejtori i Përgjithshëm emëron Drejtorët e ARM-ve, sipas parashikimeve në Urdhërin e Kryeministrit.
12. Drejtori i Përgjithshëm emëron Zëvendës Drejtor, një nga Drejtorët e AKM-së.
13. Zëvendës Drejtori kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë vendim dhe ushtron të gjitha kompetencat e deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm.
14. Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së:
 - a) Përfaqëson AKM-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e veprimtarisë së AKM-së;
 - b) Ka të drejtën dhe autoritetin të lidhë marrëveshje mbështetur në legjislacionin shqiptar me qëllim përmbushjen e objektit të punës së AKM-së;
 - c) Emëron dhe shkarkon nga detyra punonjësit e AKM-së, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;
 - d) Administron buxhetin e miratuar të AKM-së, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;
 - e) Përgatit projekt buxhetin vjetor të AKM-së për vitin e pasardhës dhe ia propozon Ministrit;

- f) Nxjerr urdhëra dhe udhëzime për përcaktimin e procedurave, detyrave, të drejtave dhe përgjegjësiave për AKM;
- g) Koordinon aktivitetet e AKM-së me institucionet e pushtetit qëndror dhe vendor, si dhe ente të tjera publike;

V. SELIA, STEMA DHE VULA ZYRTARE E AKM-së

- 15. AKM ka zyrën qendrore të saj në Tiranë dhe degë rajonale në qarqe (ARM).
- 16. AKM ka stemën dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AKM-së prodhohet në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.474, datë 10.7.2003 “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.
- 17. Në vulën zyrtare të AKM-së shkruhet me shkronja kapitale “AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT”, ndërsa në vulën zyrtare të ARM-ve shkruhet me shkronja kapitale: “AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT, AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT (emrin i qarkut përkatës)”.
- 18. ARM-të kanë zyrat e tyre në qarqet përkatëse pranë prefekturave dhe/ose bashkive përkatëse.
- 19. Selitë e zyrave të ARM-ve përcaktohen me akt të _____.

VI. FUNKSIONET E AKM-së

- 20. AKM, përmes zyrës qendrore dhe ARM-ve ushtron funksionet e mëposhtme:
 - a) Kryen funksione rregullatore për lejet e mjedisit në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës;
 - b) Monitoron dhe vlerëson gjendjen e mjedisit dhe përgatit Programin Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit;
 - c) Përgatit dhe publikon Raportin për Gjendjen e Mjedisit dhe publikime të tjera që kanë lidhje me mjedisin;
 - d) Kryen kërkime shkencore që lidhen me mjedisin ose kërkime të tjera mbi zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionin;
 - e) Përgatit PMM-të dhe dokumentat e referencës së TMD-ve.
 - f) Bashkëpunon me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe me organizata të tjera ndërkombëtare mjedisore dhe plotëson detyrimet raportuese përkatëse;
 - g) Krijon dhe menaxhon sistemin e informacionit mjedisor;
 - h) Krijon dhe menaxhon Regjistrin e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
 - i) Siguron informacion mjedisor për publikun në lidhje me çështjet mjedisore;
 - j) Siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore;
 - k) Menaxhon sistemin e të dhënave për pyjet;
 - l) Përgatit dhe mbikqyr Inventarin Kombëtar të Pyjeve;
 - m) Zhvillon Planet e Menaxhimit të Pyjeve;
 - n) Monitoron pyjet në drejtim të zbatimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - o) Siguron zhvillimin dhe transferimin e teknologjive në lidhje me pyjet;
 - p) I paraqet Ministrit projekt propozime për mbështetje teknike të financuara nga buxheti I shtetit dhe donatorë ndërkombëtarë;
 - q) I siguron publikut mundësinë për të marrë informacion mjedisor;
 - r) Shqyrton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
 - s) Këshillohet dhe bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit dhe të Inspektorateve të tjera në zbatim të legjislacionit mjedisor, përfshirë situatat e incidenteve, aksidenteve dhe emregjencave në mjedis;
 - t) Përgatit formatin standard të kërkesës, informacionin që duhet të përmbajë kërkesa, dhe formatin e lejes së mjedisit dhe ja propozon Ministrit për miratim;
 - u) Përgatit raport administrativ vjetor mbi veprimtarinë e kryer; si dhe

- v) Funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posacëm.

21. Për ushtrimin e funksioneve të saj AKM duhet të:

- a) informohet për politikën dhe objektivat e autoriteteve publike, funksionet e të cilave kanë ose mund të kenë ndikim në çështjet që mbulon Agjencia;
- b) ketë parasysh nevojën për mbrojtjen e mjedisit në nivel të lartë dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror;
- c) marrë masa për parandalimin e shkarkimeve me efekte potencialisht të rrezikshme, kur sipas saj ka arsye për të besuar që shkarkime të tilla mund të shkaktojnë ndotje të rëndësishme në mjedis;
- d) zbatojë, për aq sa është e mundur, parimin “ndotësi paguan” dhe parimet e tjera të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- e) sigurojë, për aq sa është praktike, ekuilibrin e duhur ndërmjet nevojës për mbrojtjen e mjedisit (kostos përkatëse) dhe nevojës për zhvillim ekonomik.

22. Ushtron funksionet këshillimore, me iniciativën e vet apo me kërkesë të Ministrit, si më poshtë:

- a) I rekomandon Ministrit të bëjë propozime për hartimin e akteve të reja, për ndryshime ligjore apo për çështje të tjera që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- b) Përgatit informacione për çështje të ndryshme të mjedisit për Ministrin, organe të qeverisjes qëndrore dhe vendore, sipas kërkesës së tyre;
- c) Organizon konferenca, seminare, trajnime në fushën e vet të veprimtarisë;
- d) Përgatit për Ministrin informacione vlerësimi mbi ndikimet që mund të vijnë nga propozimet për miratim apo ndryshime legjislative në nivel kombëtar apo ndërkombëtar;

VII. KONTRATAT DHE MARRËVESHJET

23. AKM:

- a) Lidh marrëveshje dhe bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore mbështetur në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e njësite të qeverisjes vendore” si dhe në legjislacionin mjedisor.
- b) Ka të drejtë të kontraktojë konsulentë për përmbushjen e funksioneve të saj. Çdo pagesë për konsulentin e kontraktuar do të mbulohet nga burimet financiare përkatëse.
- c) Lidh dhe zbaton kontratat civile të parashikuara nga Kodi Civil;
- d) Përfshin në raportin administrativ vjetor informacion mbi marrëveshjet dhe kontratat e mësipërme.

VIII. BUXHETI DHE LLOGARITË

24. Buxheti i AKM-së financohet nga Buxheti i Shtetit.

25. AKM siguron të ardhura edhe nga shërbimet e kryera prej saj ndaj palëve të tjera. Tarifën e këtyre shërbimeve përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

26. AKM administron të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe ato të siguruar nga shërbimet ndaj palëve të tjera.

27. AKM harton projekt-buxhetin vjetor mbi bazën e projekt-programit vjetor të saj.

IX. DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

28. Ministri brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duhet të marrë masat për t’i paraqitur:

- a) Këshillit të Ministrave propozimin për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së;
- b) Kryeministrit propozimin për strukturën dhe organigramën e AKM-së.

29. Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së miraton kërkesat specifike për çdo pozicion në AKM.

30. Punonjësit që aktualisht janë emëruar në AMP dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në paragrafin 27, të këtij vendimi, transferohen në pozicionet e reja të AKM-së sipas Urdhërit të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organigramës.
31. Në cdo rast, kryerja e procedurave të punësimit bëhet në përputhje me ligjin për "Statusin e Nëpunësit Civil" i ndryshuar, "Kodin e Punës" dhe dispozita të tjera ligjore përkatëse.
32. Brenda --- muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Ministri merr masa për kalimin e zyrave, ambjenteve të punës, pajisjeve, dokumentacionit, fondeve buxhetore dhe vlerave të tjera monetare nga AMP tek AKM dhe ARM-të.
33. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi perballohen nga buxheti i shtetit miratuar për Ministrinë e mjedisit.
34. Ministri dhe AKM janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

XXIX. SHFUQIZIME

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 599, Date 20.12.1993 "Për krijimin e Agjencive Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit në prefektura" shfuqizohet.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 23.8.2006 "Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve" shfuqizohet për aq sa bie ndesh me dispozitat e këtij vendimi.

Cdo dispozitë ose akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi _____, pas publikimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA